

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 2350 Rep.
NR. 1351/ Kol.
12

KONTRATE KONCESIONI

E FORMES "BOT" (NDERTIM - OPERIM - TRANSFERIM) PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "PRELLE 1" DHE "PRELLE 2"

Ne Tirane, me date 04 muaji QUANT, viti 2008 (dy mije e tete), u paraqiten para meje notere Laura Gustina, e regjistruar ne Dhomen e Noterise Tirane me adrese Tr. "Abdyl FRASKARI", Business Center "TRILLO" palet kontraktuese si me poshte:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes percaktuar si "AUTORITET KONTRAKTUES" me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.535, date 22.08.2007 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per ndertimin me koncesion te hidrocentraleve "Prele 1" dhe "Prele 2", qe me poshte do te quhet i tille, perfaqesuar me autorizimin nr. 3086, date 12.03.2008, nga nga Z. Kristo RODI, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta

DHE

Bashkimi i perkohshem i shoqerive "ENDI - E" dhe "EKO A2", qe ne vijim do te quhet "KONCESIONARI", i formuar sipas marrveshjes nr.869/1Kol, nr.2557 Rep, date 06/12/2007 me keto te dhena:

Shoqeria "ENDI - E" rregjistruar si person juridik me Vendimin nr.35490, dt. 11/04/2006, te Gjykatës së Rrethit Tiranë/QKR,

Shoqeria "EKO A2", rregjistruar si person juridik me Vendimin nr. 29084, dt. 18/02/2003, te Gjykatës së Rrethit Tiranë/QKR.

Shoqeria "ENDI - E" është percaktuar si shoqeri kryesuese dhe perfaqesohet nga administratorët Z. Bardhyl MUCEKU, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga Pasaporta nr. dhe Z. Sokol MUCEKU, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga Pasaporta nr.

Hyrje

Duke patur parasysh qe:

Qeveria e Shqiperise:

1. I ka dhene nje rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj ose rehabilitimit te

hidrocentraleve ekzistuese me ane te procedurave te koncesionit, per permiresimin e treguesve teknike dhe ekonomike te rrjetit elektrik kombetar;

2. Konsideron ndertimin e hidrocentraleve si nje element te rendesishem te politikës se zhvillimit te sektorit te energjise.
3. Vlerëson formen "BOT" te koncesionit, si nje forme koncesioni qe ben te mundur stimulimin e investitoreve private per ndertimin e hidrocentraleve te rinj me anen e kapitalit privat.
4. Eshte e angazhuar per krijimin dhe zhvillimin e tregut te brendshem te energjise elektrike brenda vendit.
5. Mirepret investitorët vendas ose te huaj ne ndertimin e kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike.

Koncesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentraleve "Prelle 1" dhe "Prelle 2", si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
2. Eshte i interesuar te investoje ne ndertimin e hidrocentraleve "Prelle 1" dhe "Prelle 2", komuna Rukaj, rrethi Mat, me qellimin prodhimin e energjise elektrike dhe rritjen e sigurise te furnizimit me energji elektrike te zones;
3. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "ENDI - E" dhe "EKO A2" zoteron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiar, per te realizuar projektin e miratuar sipas objektit te kesaj marreveshje;
4. Zoteron aftesite drejtuese, financiare dhe teknike te kerkuara si dhe aftesite per te plotesuar kete iniciative ne perputhje me standartet nderkombetare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 "Për koncesionet" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 535, datë 22/08/2007 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentraleve "Prelle 1" dhe "Prelle 2" dhe bien dakort për sa më poshtë:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Perkufizime dhe interpretime

Kudo qe ne kete Marreveshje perdoren termat e meposhteme, ato do te kene kuptimet perkatese si me poshte si vijon :

1. **Kontrata e Koncesionit** : Kjo kontratë, aneksi/aneksat dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
2. **Ligji "Për Koncesionet"**: Ligji nr.9663 dt.18.12.2006 "Për koncesionet".

3. **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.
4. **Konçesionari:** Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "ENDI - E" me seli ne qytetin e Burrelit dhe "EKO A2", me seli ne qytetin e Tiranës.
5. **Hidrocentralet:** Hidrocentralet "Prelle 1" dhe "Prelle 2", me vendndodhje në Mat, me fuqi të instaluar 10 700 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 47 499 430 kWh. Që përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalim dhe devijim, bazenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjet dhe sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të.
6. **Objekti:** Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajta e hidrocentraleve "Prelle 1" dhe "Prelle 2" dhe transferimi i tyre nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues.
7. **Investimi:** Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe paisjen me makineritë e nevojshme të Hec-eve, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
8. **Punimet:** Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve "Prelle 1" dhe "Prelle 2",
9. **Fillimi i punimeve:** Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8 pika 2 e kësaj kontrate.
10. **Vënia në punë e hidrocentraleve:** Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.
11. **Kontratat:** Te gjitha kontratat e nenshtruara nga Konçesionari, me sipërmarrjet për realizimin e punimeve;
12. **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatëse publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate. bazuar në legjislacionin në fuqi.
13. **Tarifa konçesionare:** Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.
14. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
15. **Subjekti i furnizimit me energji elektrike:** Personi i liçencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar
16. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Konçesionari.

Neni 2

Objekti i Konçesionit

Objekti i kesaj kontrate konçesionari është :

Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve te kesaj kontrate.

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit "Për konçesionet", i jep Konçesionarit me konçesion të formës BOT (qe do te thote: Ndërtim, operim dhe transferim i te drejtes se pronesise dhe operimit ne perfundim te kontrates se koncesionit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve te kesaj kontrate):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajten e hidrocentraleve "Prele 1" dhe "Prele 2" dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.



Neni 3

Karakteristikat e hidrocentraleve "Prele 1" dhe "Prele 2"

Hidrocentralet "Prele 1" dhe "Prele 2" do të ndërtohen në rrjedhën e lumit të Urakes, në Rrethin e Matit, me këto karakteristika:

Per hidrocentralin "Prele 1"

- Kuotat e veprave
 - o Kuota e vepres se marrjes 353 m
 - o Kuota e godines se centralit 220.41 m
 - o Prurja ilogaritëse 6.23 m³/s
- Fuqia e Instaluar 6 600 kW
- Prodhimi i energjisë elektrike 29 433 430 kWh

Per hidrocentralin "Prele 2"

- Kuotat e veprave
 - o Kuota e vepres se marrjes 217 m
 - o Kuota e godines se centralit 135 m
 - o Prurja ilogaritëse 6.33 m³/s
- Fuqia e Instaluar 4.100 kW
- Prodhimi i energjisë elektrike 18 066 000 kWh

Neni 4

Nezhgjatja e Kontratës së Konçesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Konçesionarit me konçesion ndërtimin e hidrocentraleve "Prele 1" dhe "Prele 2" në një periudhë 35 (tridhjetepese) vjeçare.

Një vit para përfundimit të kësaj periudhe palët me vullnet të përbashkët mund të zgjasin afatin e kësaj kontrate. Kur vlerësohet se, nga ana e Konçesionarit janë përmbushur me korrektësi të gjitha detyrat dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.

Kjo periudhë do të fillon nga hyrja në fuqi e kësaj Kontrate.

KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Pronësia dhe dorëzimi i aseteve të projektit

1. Titulli i pronësisë

E drejta e pronësisë mbi asetet pronë shtetërore që do t'i shërbejnë objektit të kontratës së konçesionit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, i mbetet Autoritetit Kontraktues.

Neni 6

Monitorimi dhe Mbikqyrja e Përgjithshme

1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në çdo kohë, gjatë periudhës së konçesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e konçesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

2. Mbikqyrja e përgjithshme

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë një mbikqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë mbikqyrjes së përgjithshme, Konçesionari do të njoftohet me shkrim për masat që për masat që duhet të marre dhe detyrat që do t'i lihan, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues i caktuar përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të sigurojë vazhdimësinë e kontratës pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtar dhe të sektorit.
2. Të ndihmojë Konçesionarin pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme për marrjen e licencave ose lejeve që do t'i shërbejnë për ekzekutimin e punimeve dhe implementimin e kësaj kontrate.
3. Të miratojë projektin e Zbatimit të hidrocentraleve, të përgatitur nga vete Konçesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës. Koha e nevojshme për miratimin e projektit nuk bëhet pjesë në grafikun e punimeve të parashikuar në Aneksin nr. 2 bashkëlidhur.
4. Të ndihmojë Konçesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
5. Të garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga subjekti i furnizimit të energjisë elektrike për 15 (peshëdhjetë) vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike.

6. Të garantojë Konçesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike në të njëjtën rrjedhë, nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e hidrocentraleve "Prele 1" dhe "Prele 2".

KRIEU III
TE DREJTAT DHE Detyrimet e KONÇESIONARIT

Neni 8
Detyrimet e Konçesionarit

Konçesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Konçesionari duhet që:

1. Të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Konçesionit, shoqërinë konçesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj vetëm financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentraleve dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës tek Autoriteti Kontraktues. Shoqëria e krijuar do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.
2. Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, për miratim projektin e zbatimit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
3. Të marrë të gjitha lejet dhe licensat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. Të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas Aneksit I bashkëlidhur kontratës;
5. Të marrë masa me qëllim që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
6. Të zbatojë projektin për ndërtimin e Hec-ëve "Prele 1" dhe "Prele 2" me fuqi të vendosur jo më pak se 6 600 kW për hec-in "Prele 1" dhe jo më pak se 4 100 kW për hec-in "Prele 2".
7. Të administrojë projektin nër periudatën e konçesionit;
8. Të shesë të gjithë prodhimin e energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të paktën për 15 (pesëmbdhjetë) vitet e para të prodhimit.
9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta;
10. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
13. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9 Vlerësimi i Investimeve

Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga konçesionari janë në vlerën totale prej 1 512 585 536 (Njëmiliard pesëqindedymbëdhjetëmilion pesëqindtetëdhjetëpesëmijë e pesëqindtridhjetëegjashhtë) lekësh, nga të cilat 639 613 900 (gjashtëqindtridhjetëeprerëmbëdhjetë e nëntëqind) lekë do të investohen në makineri e pajisje, sipas listes së paraqitur nga ofertuesi në procedurën konkurruese.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit
- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 1 512 585 536 (Njëmiliard pesëqindedymbëdhjetëmilion pesëqindtetëdhjetëpesëmijë e pesëqindtridhjetëegjashhtë) lekë, por jo më e vogël se 1 436 956 259 (Njëmiliard katërqindtridhjetëegjashhtëmilion e nëntëqindpesëdhjetëegjashhtëmijë e dyqindpesëdhjetëenëntë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5 % të investimit total të parashikuar.

Neni 10 Programi punimeve

Konçesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

1. Konçesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e miratimit të projektit të zbatimit.
2. Konçesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit 2 bashkëlidhur.
3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullit proceduriale për marrjen e tyre.
4. Koha e shtyrjes do të jetë sa kohë e vonesave të krijuara nga subjektet shtetërore.

Neni 11 Testimi i veprës

Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i paisjeve, për të siguruar funksionalitetin e hidrocentraleve.

Ky testim do të kryhet në kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Konçesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vlerën ose jehënën e punës të hidrocentraleve.

Neni 12 Zgjidhja e Kontratës së Konçesionit

1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

- Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidh Kontratën e Konçesionit në mënyrë të njëanshme, pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër:

1. Kur Konçesionari nuk fillon punën për 6 (gjashtë) muaj nga data e miratimit të projektit të zbatimit;
2. Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektit të propozuar nga Konçesionari;
3. Kur Konçesionari transferon aksionet/kuotat, pa miratim të Autoritetit Kontraktues;
4. Kur Konçesionari nuk jep përgjigje të argumentuar për shkeljen, brenda afatit dhe të parashikuar në nenin 24 të kësaj kontrate.

Në rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 1 e këtij neni), ai ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës.

2. Zgjidhja e kontratës nga secila palë.

- Secila palë, ka të drejtë të zgjidh kontratën pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër, kur:

- a) përmbushja e detyrimeve bëhet pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të përsoshtë të secilës palë;
- b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar me marrëveshje mes tyre.

3. Zgjidhja e kontratës me konsensus

- Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e konçesionit me pëlqim të dyanshëm.

Në rastet e zgjidhjes së njëanshme të kontratës nga secila palë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përshtetë për kohësisht administrimin e hec-eve, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të përcjprës.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliroi Konçesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e kontratës deri në momentin e dorëzimit të hidrocentraleve të Autoriteti Kontraktues.

Neni 13 Kontratat

Konçesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontrate tjetër me qëllim realizimin e objektit të konçesionit.

Në të gjitha kontratat, konçesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate konçesionit.

Përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Konçesionari.

Autoriteti Kontraktues nuk rrezikohet asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tjerëve në rast të marrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Konçesionarit.

Neni 14 Sigurimi i kontratës

Konçesionari duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë të barabartë me 10 % të vlerës totale të investimit prej 151 258 553 (Njëqindpesëdhjetënjë milion dyqindpesëdhjetëtetëmijë e pesëqindpesëdhjetëtre) lekë, para firmosjes së kontratës.

Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkelidhet kësaj kontrate.

Konçesionarit i lejohej të ç'ngurtësojë këtë vlerë vetëm pasi të ketë kryer investimin e plotë dhe të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 ditëve nga realizimi i investimit, kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë e saj.

Neni 15 Sigurimet

Konçesionari duhet të sigurojë parandalimin e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë fazës së shfrytëzimit, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 në nenit 7 të Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Konçesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit.

Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë shfrytëzimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguroesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, rrishtuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit.

Konçesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të dështimit të reparaimit.

Sigurimi do të kryhet në kufi përgjigjës jo më të ulët se 200 000 (dyqindmije) Euro për çdo ngjarje dhe 500 000 (peseqindmije) Euro e vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jete me e larte se 1000 (njemije) Euro për çdo ngjarje dhe 2000(dymije) Euro ne vit. Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 16 Tarifa konçesionare dhe vlera e rriinvestimit

1. Tarifa konçesionare

Konçesionari duhet të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarife koncesinare te barabarte me vleren e 2.5 % të energjisë elektrike të prodhuar në një vit.

Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së konçesionit.

2. Vlera e riinvestimit

Çdo 15 (pesëmbëdhjetë) vjet Konçesionari do të riinvestojë 80 % të vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet.

Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.



Neu 17 Kufizimet

Konçesionari nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë.

Për çdo transferim të kapitalit themelues të saj tek të tretët Konçesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.

Konçesionari nuk ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet në pronësi të Autoritetit Kontraktues.

Konçesionari nuk ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër pa miratim të Autoritetit Kontraktues mbi asetet që do të ndërtohen apo blihen prej tij gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

Neu 18 Raportimi

Konçesionari është i detyruar që çdo tre muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neu 19 Legjislacioni i Zbatueshem

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Konçesionari do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neu 20 Forca Madhore


Konsiderohen ngjarje të Forcës Madhore, katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin në fuqi të tyre, dhe që ndikojnë në objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur nënshkrimin e detyrimit reciproke të palëve.

Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke i rregulluar dhe shtyruar shtyrjen e punimeve ose pezullimin e tyre, në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

Në rast se kontrata do të zgjidhet për shkak të forcës madhore asnjë palë nuk do të mbajë përgjegjësi ndaj palës tjetër për kostot apo dëmet që rrjedhin nga mospërmbushja e Kontratës.



Neni 21

Hyrja në fuqi e Kontrates së Konçesionit

Kontrata e Konçesionit do të hyjë në fuqi mbasi të jetë miratuar nga Keshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Ligjin Nr.9663, datë 18.12.2006 "Për konçesionet".

Neni 22

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Konçesionit, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Konçesionit, do të jetë Gjykata e Arbitrazhit.

Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore/të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektivit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

Neni 23

Sanksionet

I. Mosrespektimi i afatit të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës 15 mujore të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Konçesionarin si më poshtë:

- a. Për shkelje të afatit të ndërtimit 0.35 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara.
- b. Për moskryerje në total të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurim, Konçesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të parealizuara.
- c. Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 lekë (dhjetemije).

2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakort me këtë kontratë, penalizon Konçesionarin si më poshtë:

- a. Në rast mosrealizimi, për një të Konçesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 17 499 430 kWh në vit, Konçesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të mosrealizuar për periudhën raportuese.
- b. Për mosrealizim deri në 10 % të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar, Konçesionari do të penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të ranguar, sipasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.

3. Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar në nenin 14.1.1.1 të kësaj kontrate koncesionare, e penalizon Konçesionarin me 0.005% të vlerës së investimit.

Sanksionet paguhen në ditën e Autoritetit Kontraktues.

Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 (tridhjetë) ditore lidhur me shkeljen.

Pas përfundimit të kësaj periudhe, kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i mund të drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 10 (dhjetë) ditësh.

Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

Artikulli 24 Rregullimi i shkeljeve

Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së konçesionit, Konçesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Konçesionarit duke pritur për një periudhë 30 (tridhjetë) ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse.

Palët me marrëveshje të përbashkët, do të diskutojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

Kjo procedurë nuk e zhyet Konçesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.

Artikulli 25 Transferimi i Aseteve


Me mbarimin e Kontratës së Konçesionit si rezultat i përfundimit të afatit të zakonshëm ose si një mbarim i parakushtshëm i saj, asetet e Konçesionit, përfshirë edhe çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Konçesionari në kantierin e Konçesionit, duhet t'i transferohen Autoritetit Kontraktues.

Transferimi do të përfshijë përpara të gjitha:

- Dorëzimin fizik të aseteve.
- Dorëzimin e dokumentave që shoqërojnë këto asete.
- Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me këto asete.

- Kalimin e tilla të pronësisë për ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga Konçesionari.

Konçesionari duhet të garantojë se këto objekte janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune.



Artikulli 26 **Mbarimi i kontratës**

Kontrata konçesionare mbaron me përfundimin e afatit 35 (tridhjetepese) vjeçar.

Mbarimi i kontratës shpreh zëvendësimin e Konçesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Artikulli 27 **Konfidencialiteti**

Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tjetër, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Artikulli 28 **Ndryshime**

Kjo kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje të shkruar të dy palëve. Çdo amendim i kësaj kontrate apo anekteve bashkëlidhur saj, do të hyjë në fuqi pasi të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe do të jetë pjesë përbërëse dhe e përndryshueshme e kësaj kontrate.

Artikulli 29 **Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit**

Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetres çdo ndryshim të adresave të kontaktit të komunikimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkojë Autoritetit Kontraktues nga konçesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.

Adresat dhe numrat e faksve zyrtare që do të përdoren janë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje janë:

Per Autoritetin Kontraktues

Per Koncesionarin

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes
Blvd. Zogu i Pare, Nr. 100
Tirane – Shqiperi

Shoqeria “ Endi E ” sh.p.k.
Lagjja e re , Burrel
Cel. 069 20 24 467



Neni 30
Rregjistrimi i kësaj kontrate

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të rregjistrohet në regjistrin e pasurive të pallogjeshme.

Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht.


AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes

Perfaqesuar me Autorizimin Nr. 3086
date 12.03.2008 te Ministris te Ekonomise,
dhe Energjetikes

Nga Z. Kristo RRODI

Kristo Rrodi



KONCESIONARI

Bashkimi i perkohshem i shoqerive
“Endi – E” dhe “EKO A2”

Perfaqesuar me prokuren e posacme
Nr.869 Rep, Nr.517/2 Kol, Tregtise
Date 28.03.2008

Nga z. Bardhyl MUCEKU

Bardhyl Muceku

